Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
ismail rushiti	**22.06.2023**	**30.06.2023**	**2023/0416**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.06.2023, OE "N.N.SH. " Vizion Project ""- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0416, kundër njoftimit për dhënie të kontratës , lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Hartimi i projektit per Galerine e Ministrise se Kultures, Rinise dhe Sportit - Prishtine" me nr. të prokurimit: "207-23-2085-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 50,000.00 €. më Nr. 2023/0416 i dt:19.06.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

- Neni 1 Qëllimi;
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

Autoriteti Kontraktues MKRS ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurim Publik për arsye se ne si OE pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi i kemi përmbushur të gjitha kërkesat dhe kriteret e Dosjes së Tenderit, duke përfshirë edhe kërkesën për inxhinier të diplomuar të Arkitekturës, të specializuar në konservim dhe restaurim të trashëgimisë arkitekturore. Argumentet që dëshmojnë se ne jemi OE i përgjegjshëm janë këto:

1. Për inxhinierin e Diplomuar të Arkitekturës, z.Shkëlqim Osmani, si pjesë e stafit tonë në këtë aktivitet prokurimi janë prezentuar të gjtiha dëshmitë e kërkuaradokumentarëtëDosjessëTenderit, me sa vijon:

- kontrata e punës (e mbështetur me një Aneks Kontratë për angazhim konkret në Procedurën e Prokurimit

''Hartimi i projektit për Galerinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Prishtinë, me numër prokurimi 207-23-2085-2-2-1.

- Diploma e noterizuar

- CV e nënshkruar nga i angazhuari

- Përvojë e punës – të ketë përvojë pune tre vjeçare në fushën e projektimit në objekte kulturore, pas përfundimit të studimeve themelore dhe të ketë së paku një referecnë në fushën e projektimit në objekte kulturore. Përvoja duhet të mbështetet edhe me Letër reference të lëshuar nga secila kompani apo insitucion lidhurme angazhimin.

Prandaj, pretendimi që z.Shkëlqim Osmani i mungon specializimi për konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore nuk qëndron për arsye se askund tek Dëshmitë e kërkuara dokumentare (neni 9.1 & 9.2 i FDT-së) nuk kërkohet asnjë dokument, çertifikatë apo dëshmi e specializimit në konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore, por kërkohet vetëm diplomë e noterizuar, gjë që është prezentuar nga ne si OE pjesëmarrës. Për më tepër, nga dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas kërkesave të FDT-së për z.Shkëlqim Osmani përveç kontratës, aneks-kontratës dhe diplomës së noterizuar si Inxhinier i Arkitekturës janë prezentuar edhe referenca të përvojës në fushën e konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë arkitekturore, të lëshuara nga institucioni i specializuar për konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore – Cultural Heritage Without Borders - CHWB për projekte të kësaj natyre të kryera nga z.Shkëlqim Osmani që nga viti 2006 e në vazhdimësi të cilat deshmojnë shumë mire përvojen dhe specializimin e tij ne konzervim dhe restaurim. Po ashtu janë prezentuar edhe referenca në fushën e projektimit në objekte kulturore, ashtu siç është kërkuar në FDT.

Sa i përket pretendimit tjetër të AK ku thuhet:

Tek kriteri – Caktimi i Menaxherit të kontratës, - Dëshmia: Vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet të jetë njëri nga arkitektet e paraqitur të lista e stafit professional. Vendimi duhet të përmbajë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emri i Autoritetit, Emërtimin e procedures dhe numrin e prokurimit). OE nuk ka prezantuar nje vendim të caktimit të projekt menaxherit te kontratës.

Dëshmia lidhur me këtë pretendim të AK:

Ne kemi dorzuar Vendimin e Menaxherit të Projektit duke specifikuar emrin e AK, Titullin e Kontratës si dhe Numrin e Prokurimit dhe Numrin e Brendshem. Ne këtë Vendim ne kemi emruar z.Shkëlqim Osmani si Menaxher të Projektit i cili është Inxhinier i Arkitekturës me përvoj 16 vjeçare.

Bashkangjitur keni dhe deshmin e Vendimit për caktimin e Menaxheri të Projektit

Bazuar në argumentet e lartpërmendura në këtë Ankesë, mund të konstatojme se me Njoftimin për vendimin e Autoritetit Kontraktues, përkatësisht me Letrën për tenderuesin e eliminuar që i është dërguar OE NNSH VIZION PROJECT, Ministria e Kulturës, Rinsië dhe Sporteve ka shkelur këto dispozita të Ligjit për Prokurim Publik:

- Neni 1 Qëllimi;

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;

- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

V E N D I M

APROVOHET, ankesa e OE "N.N.SH" Vizion Project si e bazuar

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin B58 dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Hartimi i projektit për Galerinë e Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Prishtinë		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	" GM Architecture " SH.P.K., 810061466	10000	Rr. Isa Kastrati Obj.49-K4 Nr. 41

DEKLARATË

Komisioni për Rivlerësim të ofertave për procedurën i emëruar nga zv. Sekretari i Përgjithshëm me numër 593/2023 i datës 03.05.2023 me numër të protokollit 2280/2023 me datë 08.05.2023, pas rivlerësimit të ofertave në bazë të kritereve të përcaktuar në Dosjen e Tenderit rekomandon për shpërblim me kontratë Operatorin e Ekonomik "GM Architecture" SH.P.K. me vlerë financiare 39,000.00€, si operator i suksesshëm duke i plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues është palë me interes material sipas nenit 4.1.26 të LPP-së.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **N.N.SH. " Vizion Project "**

Sqarim hyrës:Autoriteti Kontraktues MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, ka

zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: **"**Hartimi i projektit për Galerinë e Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Prishtinë", me numër të prokurimit: 207-23-2085-2-2-1,procedurë e hapur, lloji i kontratës: shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 50,000.00 €.

Autoriteti Kontraktues ka publikuarNjoftimin për Kontratë me datën 14.03.2023, Ndërsa me datë 20.03.2023 ka publikuar Formulari standard (B54) për korrigjimin e njoftimit.
AK me datë 18.04.2023 ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, ndërsa me datë 20.04.2023, OE -N.N.SH. Vizion Project, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, kunder vendimit të AK-se.

Me datë 24.04.2023, AK ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, duke aprovuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues OE -N.N.SH. Vizion Project, duke kthyer lëndën në ri-vlerësim.

Pas ri-vlerësimit, me date 02.06.2023, AK ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, ndersa OE -N.N.SH. Vizion Project, me date 07.06.2023 përseri ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim dhe me date 08.06.2023 AK ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 19.06.2023 OE -N.N.SH. Vizion Project, ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 2023/0416,dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:

<u>Përgjigje pretendimit ankimor të OE ankues:</u>

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues , ku thuhet se, "Autoriteti Kontraktues MKRS ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurim Publik për arsye se ne si OE pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi i kemi përmbushur të gjitha kërkesat dhe kriteret e Dosjes së Tenderit, duke përfshirë edhe kërkesën për inxhinier të diplomuar të Arkitekturës, të specializuar në konservim dhe restaurim të trashëgimisë arkitekturore..."

Eksperti Shqyrtuese ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor, dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit në platformën e-prokurimit, përkatësisht pretendimit të OE ankues, sqaron si në vijim:

AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht tek **Kërkesat mbi**

mundësitë teknike dhe/ose profesionaleneni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar si në vijim:

<u>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale :</u>

"Kërkesa:1. Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës (Lejohet edhe me Master) – I specializuar për konservimin dhe restaurim të trashëgimisë arkitekturore;

Dëshmitë 1. Kontratë e punës (e mbështetur edhe me një Aneks Kontratë për angazhim

konkret në Procedurën e Prokurimit Hartimi i projektit për Galerinë e Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Prishtinë me numër të prokurimit 207-23-2085-2-2-1. 2. Diploma e noterizuar 3. CV – e nënshkruar nga i angazhuari 4. Përvoja e punës të ketë përvojë pune tre vjeçare në fushën e projektimit në objekte kulturore, pas përfundimit të studimeve themelore, dhe të ketë së paku një reference fushën e projektimit në objekte kulturore. Përvoja duhet të mbështet edhe me Letër reference të lëshuar nga secila kompani apo institucion lidhur me angazhimin".

Eksperti Shqyrtues, duke u bazuar në kërkesën e vendosur nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë, konkretisht te **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionaleneni 9.1 & 9.2,** si dhe duke marrë parasysh dëshmitë e prezantuara nga OE ankues, për inxhinierin e Diplomuar të Arkitekturës, z.Shkëlqim Osmani, Eksperti shqyrtues konsideron se, dëshmitë e ofruara nga OE ankues nuk e përmbushin kërkesën e lartë cekur të dosjes së tenderit. **Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar.**

Dëshmitë dhe referencat e prezantuara nga OE ankues, për z.Shkëlqim Osmani nuk janë të mjaftueshme, për faktin se, kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë "Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës (Lejohet edhe me Master) – I specializuar për konservimin dhe restaurim të trashëgimisë arkitekturore". Andaj, sipas dëshmive të paraqitura nga OE ankues, nuk mohohet fakti që z.Shkëlqim Osmani ka përvojë dhe ka kryer aktivitete të tilla në fushën e konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë arkitekturore, por meqenëse në kërkesën e lartë cituar, AK ka kërkuar "Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës **(Lejohet edhe me Master) –I specializuar për konservimin dhe restaurim të trashëgimisë arkitekturore**", pra përveç referencave ku tregohet natyra e aktiviteteve, nuk ka prezantuar edhe dokumete tjera që tregojnë specializimin specifik për konservimin dhe restaurim të trashëgimisë arkitekturore.

Andaj, konsideroj se në rastin konkret, kur përcaktohet si term në dosjen e tenderit "**i specializuar**", nënkuptohet që të ketë njohuri dhe ekspertizë të veçantë e specifike në fushën përkatëse. Kështu që, si dëshmi e aftësisë në rastin konkret mund të dëshmohet me diplomë, certifikatë apo licencë për specializimin përkatës.

<u>Përgjigje pretendimit ankimor të OE ankues:</u>

Lidhur me këtë pretendim ankimor, "Caktimi i Menaxherit të kontratës, - Dëshmia: Vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet të jetë njëri nga arkitektet e paraqitur të lista e stafit professional. Vendimi duhet të përmbajë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emri i Autoritetit, Emërtimin e procedures dhe numrin e prokurimit). OE nuk ka prezantuar nje vendim të caktimit të projekt menaxherit te kontratës.

Ne kemi dorzuar Vendimin e Menaxherit të Projektit duke specifikuar emrin e AK, Titullin e Kontratës si dhe Numrin e Prokurimit dhe Numrin e Brendshem. Ne këtë Vendim ne kemi emruar z.Shkëlqim Osmani si Menaxher të Projektit i cili është Inxhinier i Arkitekturës me përvoj 16 vjeçare".

Eksperti Shqyrtuese ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor, dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit në platformën e-prokurimit, përkatësisht pretendimit të OE ankues, sqaron si në vijim:

AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht tek **Kërkesat mbi**

mundësitë teknike dhe/ose profesionaleneni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale :

"Kërkesa:6. Caktimi i Menaxherit të kontratës;

Dëshmitë 1. Dëshmia Vendimi për përcaktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet njëri nga arkitektet e parqitur të lista e stafit profesional. Vendimi duhet të përmbajë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedures dhe numrin e prokurimit)".

Eksperti Shqyrtues, duke u bazuar në kërkesën e vendosur nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë, konkretisht te **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionaleneni 9.1 & 9.2,** si dhe duke u bazuar në dëshmitë e prezantuara nga OE ankues, lidhur me caktimin e Menaxherit të Projektit , Eksperti shqyrtues konsideron se, dokumenti I prezantuar nga OE ankues i përmbanë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedures dhe numrin e prokurimit), sipas kërkesës në dosjen e tenderit. **Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.**

Provë:

VIZION PROJECT

DATA: 05.04.2023
VENDI: PRISHTINË

DEKLARATA E MENAXHERIT TË PROJEKTIT

Kompania N.N.SH "VIZION PROJECT" nga Prishtina cakton z.Shkelqim Osmani me profesion Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës i Specializuar në Konzervim dhe Restaurim në poziten e Menaxherit të Kontratës

Autoriteti Kontraktues: **MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

Titulli: **Hartimi i projektit për Galerinë e Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Prishtinë**

Numri i Prokurimit: 207-23-2085-2-2-1
Numri i Brendshem: 207-23-006-2-2-1

z.Shkelqim Osmani me pervoj pune 16 vjeqare me titull Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës i Specializuar në Konzervim dhe Restaurim ka qene menagjer i projekteve të ndryshme qe ka bërë kompania N.N.SH "VIZION PROJECT" te cilat i ka përfunduar me afat të parapar sipas autoritetit kontraktues.

N.N.SH "VIZION PROJECT"

Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës
Shkelqim OSMANI

Rr.B Hyrja C15/13 Nr.3 & 4 Tel: +383 (0) 45 222 888, +383 (0) 44 261 361
vizionproject@yahoo.com, www.vizionproject.com, Prishtinë

Eksperti shqyrtues konsideron se, Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij, prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në njoftim për kontratë.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **N.N.SH. " Vizion Project "**

ismail rushiti